

HIDRO IZOLUESIT



HIDROFIX MONO

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Gri	25 KG	1.2(kg/m ²)/mm trashësi

PËRSHKRIM

Material hidroizolues monokomponent me fleksibilitet të lartë me bazë çimento, inertesh të seleksionuar me rërë të imët me aditiv specifik dhe polimer sintetik fleksibël. Ka punueshmëri të mirë dhe falë rezinave sintetike përbërëse ka aftësi shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve (gjithmonë të qëndrueshme dhe të pas-tra) në betone dhe mure, duke krijuar një shtresë fleksibël dhe të papërshkueshme. Për ambiente të jashtme dhe të brendshme.

FUSHA E APLIKIMIT

Veti shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve. Mbrojtje fleksibël dhe hidroizoluese për banjo dhe dushe. Hidroizolues përpara vendosjes së pllakave qeramike për suva, dysheme, sipërfaqe betoni. I përshtatshëm për riparime mbi parafabrikatë. Mbrojtës i sipërfaqeve të betonit në efektin e lagështisë së vazhdueshme, klorureve, sulfateve etj.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamentet duhet të jenë të qëndrueshëm dhe të pastër nga pluhurat, vajrat etj. Bazamentet me çarje të mëdha duhen riparuar me llaç riparues. Nëse sipërfaqet që do të mbulohen kanë aftësi të mëdha thithjeje lagini më parë me ujë. Në raste temperaturash të larta ose erërash të forta ju këshillojmë që të mbronin sipërfaqen nga tharja e shpejtë.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Përzieni një thes 25 kg me 7-8 litra ujë të pastër me një përzierës mekanik ose manual derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Koha e punueshmërisë së përzieries është 2-3 orë.





APLIKIMI

Aplikoni produktin në dy shtresa me furçë ose shpatull, duke e aplikuar rreth 2mm për çdo dorë duke vendosur në dorën e parë një rrjetë me fibra qelqi mbi produktin e njomë. Dora e dytë aplikohet pas një periudhe prej 4-6 orë nga njëra-tjetra, në varësi të kushteve atmosferike dhe jo para tharjes së dorës së parë. Aplikoni produktin në temperaturë nga +5°C deri +35°C.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	pH i përzierjes: 13
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350kg	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Ngjyra: Gri	Trashësia për shtresë: 1-2 mm (për dorë)
Konsumi: 1.2 kg /m ² /mm trashësi	Koha midis duarve: 2-4 orë
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	I shkëlshëm: Pas 24-48 orësh
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Aplikimi i pllakave sipër bëhet: Pas 3-5 ditësh
Masa vëllimore: 1.6-1.7gr/cm ³	Forca ngjitime në beton (28 ditë): ≥0.5 N/mm ²
Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1	Forca ngjitime në nxehtësi: ≥0.5 N/mm ²
Ujë për përzierje: 7-8 litra ujë për 25 kg	Përkueshmëria ndaj ujit: I papërkueshëm
Kokrrizimi: 0.7 mm	



Kujdes! Mos përzieri asnjë produkt tjetër me Hidrofix Mono dhe për të aplikuar dorën e dytë duhet të siguroheni që dora e parë të jetë plotësisht e thatë. Mos aplikoni mbi hidroizolues bituminoze. Shmangni aplikimin në ditë të nxehta ose më shumë erë, mbi bazamente me ngrica dhe në fazë shkrirje. Sigurohuni që bazamenti të jetë plotësisht i thatë për të realizuar veshje me pllaka.